

RAPORT MBI GJENDJE N E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË VENDET PARABURGIMIT GJATË PERIUdhËS NËNTOR 2007 - MARS 2008

Hyrje

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja), organizata e parë e të drejtave të njeriut e krijuar në vitin 1990 ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar është një nga fushat kryesore të vëzhgimeve të KSHH-së.
2. Gjatë periudhës Nëntor 2007 - Mars 2008, KShH realizoi vëzhgime në institucionet e paraburgimit dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim të cilët kishin seksione paraburgimi në kohën e vëzhgimit. Më konkretisht u vëzhguan institucionet e paraburgimit: 'Jordan Misja' në Tiranë, 'Mine Peza' në Tiranë, Korçë, Kukës, Tropojë, Durrës, Berat, institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim Lezhë, Vaqarr, Rogozhinë, Peqin, Krujë, 'Ali Demi' në Tiranë dhe Spitali i Burgjeve në Tiranë.
3. Qëllimi i monitorimeve ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të personave të paraburgosur në përgjithësi dhe i të drejtave të grave dhe të miturve të arrestuar në veçanti.
4. Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar më konkretisht në Kushtetutën e R. SH-së, Kodi e Procedurës Penale, ligjin nr. 8328, datë 16.04.1988, "Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Rregullorja "Për policinë e burgjeve", Rregullorja e paraburgimit e vitit 2006. Rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës për Shqipërinë, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të KSHH-së u mbajtën gjithashtu parasysh.
5. Gjatë vëzhgimeve u morën takime të drejtpërdrejta me të paraburgosurit, takime me drejtues të institucioneve të paraburgimit, përgjegjësit dhe specialistët e sektorëve të sigurisë, të kujdesit social dhe sektorit juridik, shëndetësorë dhe të personelit. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KSHH-së me profesion juristë dhe mjekë.
6. Raporti paraqet problemet më të përgjithshme të konstatuara në institucionet e vëzhguara. Gjatë vëzhgimeve, vëzhguesit e KSHH-së patën mundësi të marrin takime me të paraburgosurit dhe të dënuarit dhe të komunikojë lirshëm me ta.
7. KSHH-ja vlerëson kalimin e vendeve të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithatë ky kalim është shoqëruar me disa vështirësi si: infrastruktura e keqe e

trashëguar nga Komisaritet e Policisë dhe mungesa të theksuara në pajisje teknike dhe burime njerëzore.

8. Duke vlerësuar ndikimin që ka infrastruktura dhe kushtet fizike të institucioneve të paraburgimit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre, KShH-ja vëzhgoi kushtet e paraburgimit në institucionet objekt vëzhgimi. Kushtet fizike të institucioneve të paraburgimit që ishin në ambienteve të komisariateve të policisë ishin të këqija, sidomos në institucionet e paraburgimit: Korçë, Vlorë, Kukës, dhe Tropojë. Dhomat e paraburgimit në ndonjë rast ishin edhe nën tokë (në Korçë). Baza materiale me të cilën pajisen të paraburgosurit si krevate, dyshekë, batanije, çarçafë, etj ose mungonin ose ishin të vjetruara.
9. Në shumicën nga këto institucione dhe sektorë paraburgimi nuk kishte ambient të veçantë për të miturit. Sipas personelit të këtyre institucioneve, ambiente të veçanta për të miturit konsideroheshin një ose disa dhoma të veçanta brenda sektorit të të rriturve, me mundësi kontakti me ta. Vetëm në institucionet e paraburgimit 'Jordan Misja', Tiranë dhe në Durrës, si edhe në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim Lezhë, ambientet për të miturit ishin në sektorë të veçantë.
10. Ambientet e qëndrimit të të miturve në institucionin e paraburgimit "Jordan Misja" në Tiranë ishin duke u rikonstruktuar në kuadër të një projekti të financuar nga UNICEF, Shqipëri. Ky ambient do t'u mundësojë të miturve jo vetëm kushte më të mira fizike, por edhe mundësi për të zhvilluar kurse të ndryshme profesionale që lidhen drejtpërdrejt me trajtimin e tyre.
11. Në institucionin e paraburgimit 'Mine Peza' në Tiranë, si edhe në seksionet e paraburgimeve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim, infrastruktura dhe kushtet fizike ishin më të pranueshme. Përmirësime të infrastrukturës kishte në ambientet e paraburgimit në Krujë, Durrës dhe Berat. Nga të miturit e dënuar që u intervistuan në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim të Vaqarit u mësua se në përgjithësi kushtet e dhomave ishin të pranueshme dhe nuk kishin ndonjë ankesë specifike, me përjashtim të mungesës së sistemit të ngrohjes së dhomave gjatë dimrit.
12. Mbipopullimi ishte një problem shqetësues pothuajse në të gjitha institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim të vëzhguara nga KShH-ja. Gratë e paraburgosura në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja', Tiranë dhe të dënuarat në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim 'Ali Demi', Tiranë, përballëshin me një mbipopullim të tejskajshëm që sillte probleme serioze në trajtimin e tyre respektimin e të drejtave të tyre.
13. Nga vëzhgimet e kryera, rezultoi se të miturve të paraburgosur dhe të dënuar u rezervoheshin një trajtim i veçantë për sa i takon ajrimin. Thuaftë në të gjitha institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim, të miturit dilnin në ajrim veçmas nga të rriturit dhe/ose në orare të ndryshme. Në përgjithësi, orari i ajrimit për të mitur ishte më i zgjatur në krahasim me atë për të rriturit. Megjithatë, në shumë institucione, ajrimi kryhej në varësi të ambienteve dhe kushteve fizike faktike që ka

çdo institucion. Në ndonjë institucion si për shembull në Vaqarr, të miturit kishin mundësi kontakti me të rriturit gjatë kohës së ajrimit.

14. Gratë e paraburgosura dhe të dënuara në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë dhe në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim 'Ali Demi' Tiranë, kishin orar më të zgjatur ajrimi.
15. Zbatimi i normës ushqimore për personat e paraburgosur dhe të dënuar, ishte objekt vëzhgimi të KShH-së. Norma e re ushqimore kishte filluar të zbatohet në të gjitha institucionet e paraburgimeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale të vëzhguara, përveç atij në Berat. Vëzhguesit konstatuan se kishte tendencë për të mos e konsumuar ushqimin që ofron institucioni, për shkak të mendësive lidhur me cilësinë e ushqimit, të përgatitjes dhe shpërndarjes së tij. Disa të paraburgosur në vendet e paraburgimit Lezhë u ankuan se ushqimi nuk ishte në përputhje me standardet ligjore. Kjo i detyronte ata që në pjesën më të madhe të rasteve të mos e konsumonin atë, por të konsumonin ushqimin e sjellë nga familjarët. Të paraburgosurit e pyetur në Tropojë kishin të njëjtin shqetësim për cilësinë e ushqimit. Ushqimi nuk kontrollohej nga mjeku, pasi nuk kishte mjek me kohë të plotë.
16. Nga vëzhgimet e kryera rezultoi se kushtet higjieno sanitare në institucionet e paraburgimit të Kukësit, Tropojës, Korçës nuk ishin të mira. Mungesa e dritave, e ujit, godina të vjetra dhe të amortizuara bëjnë që kjo e drejtë të shkelet. Në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, seksioni i të miturve kishte mangësi për sa i takon kushteve higjienike. Sipas të miturve të intervistuar kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës së personelit të institucionit. Në institucionin e paraburgimit Korçë mungonin kushtet për t'u kujdesur për higjienën vetjake, sepse kishte vetëm një dush. Të paraburgosurit ishin të detyruar të laheshin me kova ose nuk mund të laheshin paradite pas aktiviteteve sportive. Në institucionet e paraburgimit të vëzhguara të Beratit e Durrësit kishte përmirësime të kushteve higjieno sanitare. Ndonëse në vendin tonë ka një institucion për gratë e dënuara (institucioni 'Ali Demi' Tiranë), kushtet higjienike të tualeteve ishin të këqija. Kishte mungesa sa i takon sasisë së tualeteve dhe dusheve. KShH më datë 22 Janar 2008 reagoi me një deklaratë publike ku kërkoi që ky problem të vlerësohet me seriozitetin e duhur, në mënyrë që të merren masat përkatëse për përmirësimin e gjendjes.
17. Shërbimi shëndetësor ishte në nivele të ndryshme në institucione të ndryshme. Në institucionin e paraburgimit Durrës dhe në Berat, shërbimi shëndetësor ishte përmirësuar; kishte një mjek të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme, kishte një libër për mjekimet dhe kartela personale për të paraburgosurit sipas formatit të Ministrisë së Drejtësisë. Për të miturit që gjendeshin në dhomat e paraburgimit në Durrës dhe në Berat, kartelat shëndetësore ishin të plotësuara. Ndërsa në institucionin e paraburgimit të Vlorës, Tropojës dhe Kukësit nuk kishte mjek, mungonin të gjitha medikamentet mjekësore dhe shërbimi stomatologjik. Problemet mjekësore i zgjidhin në spitalin civil. Lidhur me problemet e kontaktuara, KShH në datën 17 Nëntor 2007 reagoi përmes një deklaratë publike për mungesën e shërbimit mjekësor në institucionin e paraburgimit të Vlorës si edhe për kushtet e këqija higjieno-sanitare. Në disa institucione, në momentin e vëzhgimit

mungonin shumë ilaçe. Pjesa më e madhe e të paraburgosurve dhe të dënuarve i blinte vetë ilaçet dhe administrimi i tyre bëhej më pas nga mjeku i institucionit. Personat e intervistuar kishin ankesa për cilësinë e shërbimi mjekësor dhe për llojet e medikamenteve që u ofroheshin, pasi sipas tyre nuk ishin efektive.

Në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, ku mbahen femrat e paraburgosura dhe në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim 'Ali Demi' Tiranë, ku mbahen femrat e dënuara, kishte një mjek të përgjithshëm dhe tre ose katër infermierë me kohë të plotë, por mungonte mjeku psikiatër (ndonëse kishte të sëmura mendore) dhe mjeku gjinekolog.

18. Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të Krujës ishte siguruar shërbimi shëndetësor 24 (njëzetë e katër) orë në ditë nga një staf i specializuar mjekësh, ku përveç mjekëve patologë, kishte dhe një psikiatër. Nga verifikimi i Librit të Furnizimeve me medikamente u vu re se një sasi e mjaftueshme ilaçesh. Në kohën e vëzhgimeve, institucioni ishte i furnizuar me ilaçe.
19. Në shumë vende paraburgimi mungonte plotësisht shërbimi stomatologjik, mungonte baza materiale dhe të gjitha medikamentet stomatologjike. Mungesa e shërbimit stomatologjik e detyronte personelin e burgut që një shërbim të tillë ta ofronte nëpërmjet klinikave private kundrejt pagesës së të paraburgosurve. Në institucionet ku mbahen të miturit si: Vaqarr, Korçë, në institucionin 'Jordan Misja' Tiranë, Berat, Durrës mungonte tërësisht shërbimi stomatologjik. Edhe në rastet kur kishte pasur shërbim stomatologjik, si në institucionin e Vaqarrit, ai ishte tejet i keq. Nga pretendimet e të paraburgosurve të intervistuar, edhe kur shërbimi stomatologjik ofrohej nga institucioni, ata ishin të detyruar shpesh të prisnin me ditë të tëra. Lidhur me shqetësimet e mësipërme, KShH i ka dërguar një letër të hapur Kryeministrit të vendit si edhe Ministrit të Drejtësisë duke kërkuar marrjen e masave për trajtimin e personave me probleme mendore të cilëve u është privuar liria dhe qëndrojnë në Qendrën Spitalore të Burgjeve dhe për nevojën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet e paraburgimit ku ky shërbim mungonte.
20. **Informimi i të drejtave në momentin e ndalimit ose të arrestimit vazhdon të jetë problem shqetësues.** Shumë prej të paraburgosurve të intervistuar, ndërmjet tyre edhe të miturit në vendet e paraburgimit të Beratit, të Durrësit, të Lezhës etj. pretendonin se nuk u ishin bërë të ditur të drejtat e tyre në momentin e arrestimit. Nuk u ishte vënë në dispozicion një avokat edhe pse e kishin kërkuar një të tillë. Ishte një problem i vazhdueshëm zgjatja e proceseve për arsye jo objektive, duke i dëmtuar ndjeshëm kështu ekonomikisht të paraburgosurit. Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim në Rrogozhinë, në seksionin e paraburgimit vëzhguesit konstatuan dy raste: një djalë 15 vjeçar i akuzuar për "Armëmbajtje pa leje", kishte 4 muaj nën masën e arrestit "Burg pa afat", ndërkohë që çështja e tij ishte ende nën hetim; dy të mitur të akuzuar për vjedhjen e pak litrave naftë, ishin nën masën e arrestit "Burg pa afat".
21. **E drejta e informacionit, e ushtrimit të riteve fetare dhe aktiviteteve zbavitëse në institucionet e vëzhguara nga KShH-ja në përgjithësi zbatohet.** Nga vëzhgimet rezultoi se të paraburgosurit dhe të dënuarit lejoheshin të informoheshin nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar, bibliotekës së institucionit, si edhe nëpërmjet korrespondencës me letërkëmbim. Ekziston në fakt një dyzim standardesh sa i takon zbatimit të këtyre të

drejtave në institucione të ndryshme. Në institucionet e paraburgimit të kaluara rishtazi nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, edhe për shkak të kushteve të trashëguara, ka mangësi në realizimin e aktiviteteve zbavitëse dhe rikrijuese. Përfundimisht në institucionin e paraburgimit në Durrës, në të cilin të miturve u ishin krijuar mundësi për aktivitete të ndryshme zbavitëse. Ndërsa në institucionet e paraburgimit të Tropojës, Kukësit, Beratit dhe Korçës, nuk kishte ambient biblioteke, të paraburgosurit nuk kishin televizor nëpër dhoma dhe nuk kishin mundësi të zhvillonin aktivitete zbavitëse. Nga vëzhgimet e kryera rezultoi se të paraburgosurve dhe të dënuarve u lejohej të ushtronin ritet fetare, ndonëse në disa prej institucioneve të paraburgimit si në Korçë, Berat, Vaqarr, Kukës e Tropojë, për arsye të mbipopullimit dhe të mungesës së kushteve fizike infrastrukturore, mungonin ambientet e kultit fetar.

22. Nga vëzhgimet e kryera nga KShH-ja rezultoi se në shumicën e institucioneve të vëzhguara, puna edukative dhe programet arsimore mungonin. Programet e përgjithshme dhe të veçanta të trajtimit të të miturve ishin të vakëta, jo rezultative dhe afatshkurtra. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim në Lezhë e Vaqarr dhe në institucionin e paraburgimit në Durrës, organizoheshin disa aktivitete edukative, ndërsa në institucionet e tjera të vëzhguara këto aktivitete mungonin. Ky problem u ngrit edhe nga vetë stafi i këtyre institucioneve, i cili ose për mungesë fondesh ose për mungesë ambientesh të përshtatshme nuk kishte pasur mundësi për realizimin e këtyre programeve. Në realizimin e asistencës psiko-sociale për të miturit dhe gratë, vlen për tu përmendur ndihma e organizatave jo qeveritare që veprojnë pranë institucioneve të tilla si: institucioni i paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, në seksionin e të miturve dhe grave; institucioni i ekzekutimit të vendimeve me burgim në Vaqarr, në seksionin e të miturve; institucioni i ekzekutimit të vendimeve me burgim 'Ali Demi' Tiranë, në seksionin e femrave dhe të meshkujve.
23. Një pjesë e stafit të sektorit të edukimit është trajtuar lidhur me trajtimin e të miturve dhe grave nga KSHH-ja në kuadër të projektin të mbështetur nga UNICEF. Ata janë paisur me një një modul të veçantë trajnimi për trajtimin e të miturve dhe grave në institucionet e paraburgimeve dhe të ekzekutimit të vendimeve penale.
24. Nga vëzhgimet e kryera nga KShH-ja, në të gjitha institucionet e paraburgimit që kanë kaluar rishtazi në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, puna edukative që zhvillohej me të paraburgosurit ishte shumë e pakët dhe jo rezultateve. Në shumicën e këtyre institucioneve nuk zhvillohej asnjë program edukativ dhe psiko-social me të paraburgosurit. Në institucionin e paraburgimit të Beratit nuk kishte asnjë punonjës të sektorit të kujdesit social.
25. Përdorimi i dhunës ishte një tjetër aspekt në të cilin u fokusuan vëzhgimet e kryera nga KShH-ja. Në përgjithësi rezultoi se nuk ka pasur raste flagrante të përdorimit të dhunës ndaj të miturve nga personeli i institucionit ku ata qëndronin. Kishte disa pretendime sporadike nga disa të mitur në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, për ushtrim dhune nga disa punonjës të institucionit. Gjithashtu, në institucionin ekzekutiveve të vendimeve penale në Vaqarr ishte rasti i një të mituri që pretendonte se kur kishte qenë në institucionin e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, ndaj tij ishte ushtruar dhunë, gjë e cila është e vështirë për t'u verifikuar. Shumica e të paraburgosurve

të intervistuar në institucionin e ekzekutimeve me burgim në Rrogozhinë, në Lezhë, në Berat, në Korçë, pretendonin se ishin keqtrajtuar gjatë momentit të arrestimit ose gjatë periudhës së marrjes në pyetje.

26. Nga vëzhgimet e kryera nëpër institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim dhe në institucionet e paraburgimit nga KSHH-ja gjatë periudhës nëntor 2007 – mars 2008 rezultoi se takimet me familjarë zhvilloheshin konform kërkesave ligjore dhe rregullores së paraburgimit aktualisht në fuqi. Takimet zhvilloheshin një herë në javë dhe në bazë të kërkesave me shkrim drejtuar drejtorit të institucionit, të paraburgosurve u krijohej mundësia e takimeve shtesë në raste të veçanta. Problem ende shqetësues ishte kohëzgjatja e takimeve, që sipas personave të intervistuar ishte e shkurtër. Në institucione nuk kishte ambiente të veçanta për zhvillimin e takimeve me familjarët për personat e mitur. Përveç institucionit të paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë, ku ishte në proces ndërtimi një ambient i veçantë për takimet e të miturve me familjarët, në të gjitha institucionet e tjera të vëzhguara nuk është parashikuar krijimi i një ambienti të veçantë për zhvillimin e takimeve me familjarët për të miturit. Problem tjetër i ngritur nga të paraburgosurit e intervistuar ishte ambienti dhe mënyra e realizimit të takimeve me familjarët, pengesa të cilat shmangin kontaktin fizik me familjarët dhe shkelin të drejtën e privatësisë së tyre. Ky problem u ngrit nga të paraburgosurit e intervistuar në institucionet e paraburgimit 'Jordan Misja' Tiranë dhe në Korçë.
27. Një tjetër problem shqetësues i cili u ngrit nga të paraburgosurit thuhet në të gjitha institucionet e vëzhguara nga KSHH-ja, kishte të bënte me zvarritjen e tejskajshme të proceseve hetimore dhe gjyqësore. Mjaft ankesa pati edhe në lidhje me cilësinë e mbrojtjes. Pati madje edhe pretendime që mbrojtësi nuk ka qenë prezent gjatë ndalimit dhe arrestimit si dhe nuk është paraqitur gjatë seancave të pyetjes, çka nëse verifikohet do të përbënte një shkelje të rëndë të të drejtave të tyre si dhe pavlefshmërinë e një tërësi veprimesh procedurale të ndërtuara gjatë fazës hetimore. Gjithashtu për tu përmendur është aplikimi i shpeshtë i masës së paraburgimit, pa ndonjë trajtim të diferencuar për të miturit dhe pa marrë parasysh pozitën e veçantë të tyre, madje edhe për vepra penale që nuk paraqesin një rrezikshmëri të lartë shoqërore. Nga komunikimi me të miturit e paraburgosur të institucionit të ekzekutimit të vendimeve me burgim Lezhë rezultoi se ka raste të të miturve që qëndrojnë deri në 1 vit në paraburgim ndërkohë që procesi gjyqësor nuk ka përfunduar. Pretendime të tilla pati edhe nga 2 të paraburgosur të mitur në Berat me inicialet P. G. dhe V. M. të cilët kishin përkatësisht tre muaj e gjysmë dhe katër muaj në paraburgim dhe ende nuk kishin dalë në gjyq. Të tilla pretendime kishin edhe të paraburgosurit e mitur në institucionin e ekzekutimeve të vendimeve penale në Rrogozhinë.

Disa sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut

- 1 KSHH-ja rekomandon marrjen e masave për përmirësimin e infrastrukturës së dhomave të paraburgimit që gjenden në ambjentet e komisariateve të policisë. Pavarësisht nga fakti se është planifikuar mundësia e kalimit të dhomave të paraburgimit të disa komisariateve në mjedise të reja, është e nevojshme të merren masa për mbajtjen e personave në kushte higjieno-sanitare të përshtathme dhe të pajisen mjediset me mjetet e nevojshme për jetese.

- 2 Në institucionet e paraburgimit është e nevojshme të krijohen mjediset për mbajtjen e të miturve dhe të paisen ato me orenditë e nevojshme.
- 3 Për të zbutur problemin e mbipopullimit në vendet e paraburgimit, është e nevojshme koordinimi më i mirë i punës mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Prokurorisë me qëllim shkurtimin e afateve të hetimeve paraprake. Gjithashtu është e rekomandueshme që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bazë të vlerësimeve periodike të kapaciteve faktike në institucione të marrë masa e nevojshme për zbutjen e mbipopullimit dhe transferimin e personave në institucione përkatëse.
- 4 Lidhur me ajrimin, në institucionet ku ka të mitur, sidomos në institucionin e Lezhës dhe në në atë të Vaqarit është e këshillueshme organizimi i ajrimit në kohë të ndryshme nga koha e ajrimit për të rritur.
- 5 KSHH-ja vlerëson zbatimin e normave të reja të ushqimit në institucionet e paraburgimit dhe në burgje, por rekomandon që Drejtëoria e Përgjithshme e burgjeve, të organizojë herë pas herë kontrolle nëse këto norma zbatohen në praktikë.
- 6 Drejtuesit e policië dhe të prokurorisë duhet të marrin masa që punonjësit e tyre të respektojnë detyrimin për informimin e të drejtave në momentin e ndalimit ose të arrestimit të një personi.
- 7 Duke vlerësuar rëndësinë e programeve sociale në rehabilitimin social të të dënuarve në përgjithësi dhe të miturve në veçanti është e rekomandueshme që institucionet që rrisin bashkëpunimin e aktorë të shoqërisë civile dhe të instituioneve të tjera jashtë burgut për të organizuar veprimtari social- kulturore, edukuese etj.
- 8 Dhuna fizike dhe psikologjike duhet të parandalohet. Krahas rritjes se efektivitetit të kontrollit dhe të ndëshkimit të rasteve të keqtrajtimve, është e rekomandueshme organizimi sa më mirë i programeve ditore për të ulur stresin dhe situatën që mund të çojnë në tensione dhe çënime të rregullit. Gjithashtu, në rastet e pranimin të personave në institucion, është e detyrueshme të bëhet verifikimi i gjendjes fizike të personit dhe evidentimi i rasteve kur te personi ka shenja të përdorimit të dhunës ose pretendohet për përdorim dhune.
- 9 Është e rekomandueshme që drejtuesit e instituioneve të vlerësojnë mjediset e takimeve të personave të paraburgosur me familjarët, sidomos për takimet me fëmijët ose kur personi i paraburgosur është i mitur dhe të marrin masa për përshtatjen e tyre sipas standarteve të përcaktuara në ligjin shqiptar dhe në aktet ndërkombëtare.
- 10 KSHH-ja kërkon që mbrojtja ligjore dhe psikologjike e të miturve të jetë efektive, në interes të të mirëqënies së tij dhe jo formale. Dhoma kombëtare e Avokatisë duhet shohë mundësinë e specializimit të avokatëve për të mitur dhe të përzgjedhë në listën e avokatëve kryesisht edhe avokatë me përvojë dhe aftësi psikologjike për trajtimin e të miturve.

- 11 Lidhur me hetimin dhe gjykimin e të miturve është e nevojshme që të ndryshojë praktika e deritanishme. Arresti në burg duhet të jetë mjete i fundit dhe të zbatohet në rrate të rralla dhe afatet e hetimit paraprak të mos jenë në kufijtë maksimal që përcakton ligji.
- 12 Është e rekomandueshme që ndaj të miturve të zbatohet gjykimet e drejtëpërdrejta dhe të shkurtura dhe se dënimi me burg të jetë një masë kur rrezikshmëria e personit dhe e veprës së kryer është e theksuar.
- 13 Mekanizmat monitorues të brendshëm dhe jashtë institucioneve luajnë një rol të rëndësishëm në evidentimin e rasteve kur trajtimi i të miturit nuk është në përputhje me parimin “interesi më i lartë i fëmijës”. Nevoja e zbatimit të masave jo penale dhe dënimeve alternative është një domosdoshmëri.
- 14 Lidhur me gratë e paraburgosura, është e rekomandueshme që trajtimi i tyre të bëhen sipas standarteve të përcaktuara në Rregullat Europiane të Burgjeve, duke u siguruar të gjitha kushtet e nevojshme higjeno-sanitare, orënditë për një trajtim në përputhje me nevojat e tyre.